


BESA E SHQIPTARIT




CITTA' di CHIERI
CONSIGLIERE COMUNALE
Vincenzo Cucci

ODHISE K. GRILLO

Besa e shqiptarit

Ilustrimet nga:
BRIKENA BERDO



IBLIOTECA

BOTIMET TOENA
Tiranë 1999



Sheshi i pazarit gumëzhinte si zgjua bletësh nga shitësit që bërtisnin dhe mburrnin mallin e tyre, nga blerësit që haheshin me të zotët e mallit duke kërkuar të ulnin çmimet, nga kafshët që kërrisin, muallitnin apo pëllisnin me të madhe, nga myezinët që thërrisin nga majat e minareve dhe nga këmbanat e kishave që ishin përreth. Ngjante tamam si në pazarin e Korçës ose të Rroskovecit, siç thotë populli, edhe pse ngjarjet tona ndodhnin në pazarin e Prizrenit...

Mirëpo erdhi një çast qe zhurma u ndërpre si me urdhër, edhe pse nuk foli askush... Në pazar u futën një tufë osmanësh të armatosur gjer në dhëmbë, të cilët po têrhiqnin disa malësorë, që i kishin lidhur me zinxhirë në këmbë, në duar dhe në qafë, sikur të ishin sklevër, edhe pse kishim hyrë në shekullin e njëzetë. Malësorët ishin të lodhur, të pluhurosur e të dërrmuar dhe në këmbë, në duar e në fytyrë nxinin e skuqnin nga njollat e gjakut e nga plagët që u rridhnin si rrëke. Po megjithëse mezi u kishte mbetur një fije shpirt, trupin e mbanin drejt dhe kokën përpjetë.


Sa i panë, shitësit e blerësit morën sikush mallin e vet dhe u larguan pa bëzajtur fare e si hije. Se ata e dinin, që, pasi t'i lidhnin malësorët mirë e mirë te çinari që ngrihej në mes të sheshit, osmanët do t'i detyronin t'i pështynin vëllezërit e tyre të gjakosur e të sakatuar.


Edhe pse nuk kishte njeri përreth, përveç osmanëve e të dënuarit, oficeri thirri:

- I shikoni këta të katër? Janë armiq të Perandorisë Osmane. Janë kriminelë e kaluar kriminelëve, pasi kanë djegur depot e armëve, kanë rrëmbyer pushkë e jataganë sa kanë mundur dhe kanë ngritur krye kundër dovletit. Për këtë pashai i madh ka urdhëruar që t'u mbushen plagët me kripë dhe të lihen në shesh të pazarit që t'i pështyjë cilido që të kalojë këndejpari, si tani që janë ende gjallë ashtu edhe kur të vdesin.

Mirëpo sheshi ishte i shkretë pasi s'kishte mbetur askush nga fshatarët e qytetarët po edhe nga kalimtarët, të cilët ndërronin rrugë kur shikonin malësorët të lidhur te rrapi...

Oficeri la katër roje të armatosura për t'i ruajtur malësorët dhe vetë mori nga pas ushtarët e tjerë e u largua.






Kaloi gjysmë ore e kaloi një orë, por në shesh nuk u duk këmbë njeriu. Kur kaloi edhe një orë tjetër, në pazar na zbriti një malësor trupmadh, me një dhi që e tërhiqte pasdore. Sa hyri në shesh, një nga rojat që mbante gradat e kapterit, i thirri që larg:

- Afrohu këtu, mor malok, se të kam një llaf...
- Malësori, që e quanin Jak Përvathi, u çapit drejt rojave dhe pyeti:
- Çfarë urdhëroni, zoti kapter?
- Ka urdhëruar pashai që t'i pështysh në surrat këta kriminelë e armiq të perandorisë sonë, - e urdhëroi kapteri.
- Unë të pështyj vëllezërit e mi? - e ngriti zërin Jaku dhe në ballë i kërceu një damar i zi. - Më mirë vdes se të bëj këtë turp e marre.
- Ashtu?! - iu kërcënua kapteri dhe ia veshi me kamxhik në kurriz.

Kaq deshi Jaku, jo më shumë, dhe nuk e bëri të gjatë, po nxori revolverin nga brezi dhe e la palmuç përtokë kapterin. Rojet e tjera vunë këmbët e lepurit dhe nuk u panë nga vanë.







Sa u dëgjuan krismat,
sheshi u mbush me
osmanë të armatosur, të

cilët e rrethuan malësorin, e kapën, e lidhën në duar e në këmbë dhe e
goditën me qytat e pushkëve e me kamxhikë.

ME KAMXHIK NË KURIZ



Pastaj e morën osh, e çuan në burg dhe të nesërmen e dënuan me vdekje, megjithëse, ca nga kondakët e pushkëve e të kamxhikëve dhe ca nga grushtat e shkelmat që hëngri, ai të dukej se po jetonte minutat e fundit...



Në burg na kryente shërbimin ushtarak edhe një malësor, që quhej Pashk Mëshkalla, bashkëfshatar i Jakut dhe armik i betuar i tij, pasi një vif më parë Jaku i kishte vrarë të jatin.

Kur e mori pak veten dhe e njoihu bashkëfshatarin, Jaku i ra në gjunjë dhe iu lut:

- A ke besë, o Pashk Mëshkalla?
- Kam, si nuk kam, se nuk ka malësor që të mos ketë besë në malet tonë... Po kush të ka katandisur kështu, që e vraftë Zoti? - e pyeti Pashku.
Jaku i tregoi çfarë i kishte ndodhur dhe i tha se e kishin dënuar me vdekje.


- Mos more, - i qau hallin bashkëfshatari e armiku i tij. - Po çfarë halli ke që po më kërkon besën? Pa ngrihu më këmbë e mos u korit të më lutësh dhe më trego të vërtetën.

- Ashtu e kam hallin, o Pashk... Më duhet të shkoj gjallë-vdekur në fshat. Duhet të takoj babën e t'i them diçka. Dua t'i le një amanet para se të vdes. A më lejon të shkoj në fshat dhe të mërkurën që me yje të kthehem këtu, se e kam ditën e varjes në litar, apo nuk më beson?

- Për të besuar të besoj, se s'ka dalë gjer më sot ndonjë malësor që ta shkelë besën e dhënë, po kam hall se kushedi a vjen dot pasi rruga vade s'ka dhe mund të të kërkojnë për të të varur, që m'u thafte goja për fjalën e fundit që të thashë... Dhe ti e di mirë se po mos të të gjejnë ty, do të më varin mua. Mos harro se në shtëpi kam nënën e ve, gruan dhe pesë fëmijë, që presin bukën e gojës nga puna ime...

- Ashtu si thua ti është, po më beso: do të kthehem para se të vijë minuta e fundit e jetës sime.

- Mirë atëherë, o bashkëfshatari e armiku im, nisu e shko dhe të mërkurën që pa feksur mirë drita, të jesh këtu, në mënyrë që edhe ti të mbarosh punë edhe unë të dal faqebardhë...



paguaj me kokë fajin."




Pashku e besoi dhe e lejoi të shkonte kështu që Jaku u nis për në fsnat nëpër shi e mjegull dhe të nesërmen në drekë arriti e mbaroi punë me të jatin. Pastaj, si u tregoi si e kishte punën, u vu për rrugë...

Mirëpo si thamë? Rruga vade s'ka. Këtë e pa me sy dhe e provoi edhe Jaku gjatë kthimit për në Prizren.

Atë natë jo vetëm që nuk shikoje asgjë e mund të rrëzohesh nëpër gremina, por mund të të merrnin me vete përrenjtë e të të çonin të mbytur në det. Aq shumë shi binte dhe aq shumë vetëtinte e bubullinte sa ndofta s'kishte rënë e s'kishte vetëtitur e bubullitur tjeter herë në malësi. Jaku u bë për t'u shtrydhur dhe tërë baltë në rroba e në trup. Po kjo s'ishte asgjë fare para atyre që i ndodhën rrugës...



"Më hëngri në besë Jak Përvathi, - thoshte me vete Pashku dhe sa s'hante veten me dhëmbë. - Sa gabim kam bërë që i zura besë. Tani duhet ta paguaj me kokë fajin."



Kur shkuan në burg për të marrë Jakun dhe nuk e gjetën, oficeri nisi të ulërijë si bishë dhe e shqepi në grushta e në shkelma Pashkun.

Pashku i shkretë nuk e ndiente fare goditjen e dhembjet dhe vazhdimisht thoshte të njëjtat fjalë:

- Unë e lashë të lirë të shkonte gjer

në fshat, për t'u lënë amanetin e fundit prindërve të vet dhe ai nuk do ta hajë fjalën e nuk do ta shkelë besën, se është malësor. S'kanë dëgjuar kurrë këto male, qoftë edhe një herë, që një malësor ta ketë bërë këtë të pabërë. Se malësorët nuk janë gra, po burra. Ai do të vijë gjallë-vdekur!

Oficeri me rojat i binin ku të djeg e ku të ther dhe i çirreshin:

- Për çfarë bese na flet, mor teveqel? A nuk e sheh se të ka mashtruar? A nuk e di se do të të varin ty në vend të tij? Dhe do të të varë vetë pashai me dorën e vet. Dhe para se të të varë do të të rjepë lëkurën e do të të pjekë në hell...

Dhe bam me grushta e bam me shkelma.


Ndërkohë Jaku i coptuar e i sakatuar, me kokën të lidhur për të ndaluar gjakun që i rridhte si rrëke e duke çaluar nga këmba që e kishte thyer kur ra në një greminë, po zbriste në qytet duke u zvarritur me këmbë e me duar...


Kur po i afrohej pazarit pa se me dhjetëra e dhjetëra burra, të rinj e pleq po vërshonin nga të katër anët drejt sheshit. Atëherë ndaloj një plak dhe e pyeti:

- Ku po shkon kështu, or mik?
- Po shkoj në pazar se do të varet një roje burgu, të cilin e ka ngrënë në besë një malësor i burgosur që do të varej sot paradreke... - iu përgjigj plaku.

Sa dëgjoi këto fjalë Jaku nisi të shkulte flokët me të dy duart dhe po ulërinte si luani i myllur në kafaz:

- Më ndihmoni, o burra, të arrij në pazar sa më parë, se unë jam ai malësori që më liroi nga burgu. Nuk e kam ngrënë fjalën e nuk e kam shkelur besën!





Kur dëgjuan këto fjalë dhe e panë Jakun të copëtuar e të mbytur në gjak, shumë njerëz nisën të thërrasin:

- Një karrocë! Një karrocë!

Dhe në çast para Jakut ndaloi një pajton i tërhequr nga dy kuaj.


Me dhjetëra njerëz e hipën Jakun në karrocë. Karrocieri i ngau revan kuajt dhe sa të hapësh e të mbyllësh sytë Jaku u gjend nën tendën e rrapi, ku po bëheshin gati të varnin Pashk Mëshkallën...



Sa pa Jakun që po e zbrisnin nga pajtoni, Pashku e hoqi litarin nga gryka lhe bërtiti:

- Ja ku është besa shqiptare, o pasha! A po e sheh me sytë e tu, apo jo? Edhe i vdekur Jak Përvathi do të ngrihej nga varri, si Kostandini i baladës e do të vinte këtu, siç erdhi tani, për të mos e shkelur besën. Se ai është shqiptar!

Dhe zbriti nga podi, e përqafoi Jakun si ta kishte vëlla dhe të dy bashkë shkuau para pashait.



Pashai u mahnit nga kjo e papritur dhe tha:

- Falur ju qoftëjeta të dyve, se e pashë me sytë e mi se ç'besë kanë shqiptarët.

Sheshi buçiti nga thirrjet e qindra e qindra njerëzve që nisën të këndojnë, të hedhin valle dhe të bartin mbi krahë Jakun e Pashkun...

LEGJENDA SHQIPTARE - 2

libra të ilustruar për fëmijë

BESA E SHQIPTARIT

Autor: Odhise Grillo

Piktore: Brikena Berdo

Përkujdesja grafike: Irena Toçi

Janë në qarkullim nga e njëjtë kolanë:

SKËNDERBEU

BESA E SHQIPTARIT

DY BATOT DHE ZANA E ILIRISË

TRIM MBI TRIMA, GJERGJ ELEZ ALIA!

MARO KONDA, TRIMËRESHË!

PRITE, PRITE AZEM GALICËN!

KAPEDAN ÇELO PICARI

LEGJENDA E NJË SHKËMBI

OSO KUKA NË KULLË T'BAROTIT

KOSTANDINI DHE DHOQINA

ZANAT E MALIT DHE FUQIA E MUJIT

KALAJA E ROZAFATIT

NËNA ME ZEMËR TË MADHE